**L I G J Nr. 9506,**

**datë 3.4.2006**

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8626, DATË 22.6.2000 "PËR STATUSIN E INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr.8626, datë 22.6.2000 "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

**Neni 1**

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

**"Neni 9**

Shteti përjashton të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë nga pagesat për kontributet shëndetësore dhe u jep të drejtën e përfitimit falas të barnave, të mbuluara nga skema e sigurimeve të kujdesit shëndetësor.

Paraplegjikët dhe tetraplegjikët, të cilët kanë përfituar statusin, përfitojnë një shtesë në të ardhura për mbulimin e shpenzimeve të paketës së domosdoshme me materiale të veçanta higjieno-sanitare. Masa, kriteret dhe procedura e përfitimit të kësaj shtese në të ardhura përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4840, datë 25.4.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu